



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

*Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;*

*E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al*

Nr. 732/7 Prot.

Tiranë, më 15.12.2017

**V E N D I M**

**Nr. 168, Datë 15.12.2017**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË ish MINISTRINË E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE MBI "AUDIMIN TEMATIK PËR ZBATIMIN E KONTRATËS NR. 3150, DATË 14.4.2017 ME OBJEKT: LUFTIMI ME PESTICID I MIUT TË ARAVE" (AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE).**

Nga auditimi tematik i ushtruar në ish Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave) me objekt: "Zbatimin e kontratës nr. 3150, datë 14.4.2017 "Luftimi me pesticid i miut të arave për vitin 2017", i cili u realizua në bazë të sinjalizimit të bërë në KLSH, me shkresën nr. s'ka, datë 04.7.2017 u konstatua se, ka devijime të cilat janë materiale për nga natyra që lidhen me hartimin, zbatimin, monitorimin e kontratës. Më konkretisht:

1. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 3150, datë 14.4.2017 konstatohet se ka mangësi dhe mospërputhshmëri me legjislacionin për prokurimin publik dhe konkretisht në hartimin e "termave të referencës", pasi sipërfaqet që do të trajtohen me pesticid nuk janë detajuar deri në nivel njësie administrative të ndarë sipas fshatrave. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me nenin 23, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime.
2. Kushti i vendosur në kontratë në nenin 4, pika 4.2 si dhe në pikën 5.3 të "Specifikimeve Teknike" bashkangjitur kontratës, bie ndesh me VKM nr. 1188, datë 20.8.2008 me ndryshime "Për miratimin e rregullave për importin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin produkteve për mbrojtjen e bimëve", në të cilin përcaktohen qartë rregullat për magazinimin e këtyre produkteve.

Megjithëse një kusht i tillë është vendosur në kontratë, ai nuk është kundërshtuar nga Drejtoria e Bujqësisë Fier dhe për pasojë, nuk është zbatuar neni 4, pika 4.2 e kontratës nr. 3150, datë 14.4.2017 sipas të cilës kërkohet “të përcaktohen ambientet për magazinimin nga ana e “të kontraktuarit” të preparatit jo më vonë se 2 (dy) ditë) para fillimit të trajtimit” si dhe nuk ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i DB-Fier në ambientet e caktuara për magazinim nga “i kontraktuari”, sipas pikës 5.3 të Specifikimeve Teknike.

**3.** Grupi i punës ngritur me Urdhrin nr. 150, datë 14.4.2017 e Sekretarit të Përgjithshëm për monitorimin e kontratës në asnjë rast nuk ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Bujqësisë Fier (rasti konkret i auditimit) për të bërë monitorimin fizik të kryerjes së shërbimit sipas grafikut të punimeve bashkangjitur kontratës, por ka bërë vetëm monitorimin e dokumentacionit dhe pse kontrata është e llojit “shërbim”, duke vepruar në kundërshtim me nenin 77 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**4.** Me Urdhër Shpenzimin nr. 186, datë 8.6.2017 është likuiduar OE “B” në vlerën 18,456,528 me TVSH si dhe OE “A” me Urdhër Shpenzimin nr. 187, datë 8.6.2017 në vlerën 73,826,112 lekë me TVSH. Likuidimi është bërë bazuar në faturat tatimore të shitjes nr. 161, datë 30.5.2017 dhe nr. 601, datë 30.5.2017 të cilat nuk janë plotësuar nga shitësi (OE) në të gjithë elementët e saj, me vlerë, sasi dhe çmim/njësi, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014. Datë 27.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shuar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime, neni 101 si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 6. Likuidimi nuk është bërë në total për llogari të bashkimit të operatorëve por është bërë për secilin operator ekonomik veçmas, pasi në kontratën nr. 3150, datë 14.4.2017, neni 9, është përcaktuar në mënyrë jo të qartë se pagesat do të kryhen nga AK në llogaritë bankare të OE.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

## **VENDOSA**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për, audimin tematik për zbatimin e kontratës nr. 3150, datë 14.4.2017 me objekt: Luftimi me pesticid i miut të arave” të ushtruar në ish Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, sipas programit të auditimit nr. 732/1, datë 07.9.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 3150, datë 14.4.2017 me objekt “Shpenzime mbrojtje bimësh dhe luftimi parazitëve në bujqësi, Luftimi i Miut të Arave, viti 2017”, konstatohet se kontrata ka mangësi dhe konkretisht në hartimin e “termave të referencës” pjesë integrale e kësaj kontrate, pasi sipërfaqet që do të trajtohen me pesticid janë shprehur vetëm në njësi matëse (në ha) në bazë qarqesh. Ato nuk janë detajuar edhe mbi bazë njësie administrative të ndara sipas fshatrave dhe pse një informacion i tillë administrohet paraprakisht nga ish MBZHRAU. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me nenin 23, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime.

Detajimi i sipërfaqeve në nivel njësie administrative duhet të bëhet paraprakisht pasi i shërben llogaritjes së fondit limit dhe nuk mund të vendoset kusht në këtë lloj kontrate, pasi ndodhemi në rastin e “emergjencës” dhe kushtet e kontratës duhet të mirë përcaktohen qartë, për të mos patur ekvivok gjatë zbatimit të saj. Nga praktika rezulton se “Miu i arave” si lloj brejtësi i rrezikshëm është evident në çdo stinë të vitit. Me qëllim mbrojtjen ndaj tij, Drejtoritë e Bujqësive në qarqe, evidentojnë çdo vit sipërfaqet që do të trajtohen me pesticide dhe i dërgojnë të dhënat në ministri. Pikërisht këtij fenomeni, Ligji nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve” me ndryshime dhe konkretisht neni 13, i ka kushtuar rëndësi duke sanksionuar që në buxhetin vjetor të ministrive të planifikohen “Fondet e veçanta për mbrojtjen nga parazitët të bimëve të kultivuara apo spontane”.

Nga ana tjetër nga verifikimi i bërë në Drejtorinë e Bujqësisë Fier dhe nga ballafaqimi me specialistin e mbrojtjes së bimëve dhe njëkohësisht anëtar i grupit për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit sipas Urdhrit nr. 178, datë 21.4.2017 të Drejtorisë së Bujqësisë Fier, detajimi i sipërfaqeve është bërë duke u bazuar në sondazhet, kërkesat e fermerëve, praktikën dhe eksperiencën e mëparshme por nuk është bërë fizikisht në terren (matje), për shkak të pamundësive objektive e subjektive. *(trajtuar më hollësisht në fq. 8 të Raportit).*

**1.1.** KLSH realizoi misionin e auditimit tematik në lidhje me zbatimin e kontratës nr. 3150, datë 14.4.2017 me objekt: Luftimi me pesticid i miut të arave”. Në këtë mision auditimi u konstatuan mangësi dhe shkelje në drejtim të zbatimit dhe monitorimit të kontratës, të cilat për të dhënë një pamje më të qartë të fenomenit, duhet që të auditohet në tërësinë e tij procesi i prokurimit të kësaj procedure, trajtuar më hollësisht në fq 7-11 të Raportit.

**Rekomandoj:** Të merren masa që në të ardhmen, hartimi i “termave të referencës” pjesë integrale e kontratave të shërbimit me objekt: “Luftimi me pesticid i miut të arave” dhe konkretisht, përcaktimi i sipërfaqeve që do trajtohen me pesticid të shprehet jo vetëm në njësi matëse (në ha) në bazë qarqesh, por të saktësohen sipërfaqet edhe mbi bazë njësie administrative të ndara sipas fshatrave, në mënyrë që të përshkruajnë në mënyrë të plotë dhe të qartë objektin e prokurimit si dhe të mundësojë monitorimin dhe zbatimin e kontratës. Detajimi i sipërfaqeve në kontratë duke mos ia lënë si detyrim këtë Drejtorive të Bujqësive në qarqe pas nënshkrimit të kontratës, sjell si pasojë që specifikimet teknike (terma reference dhe grafik punimesh) të shprehin qartë objektin e kontratës dhe të jenë transparente duke mos krijuar kushte për diskriminimin e ofertuesve.

**1.1.** KLSH të parashikojë në planin e auditimeve, auditimin e plotë të procedurës së prokurimit me objekt: ”Shpenzime mbrojtje bimësh&luftimi parazitëve në bujqësi, Luftimi i Miut të Arave, viti 2017”, në mënyrë që të jepet opinion i drejtë nëse është përzgjedhur nga Autoriteti Kontraktor-ish MBZHRAU në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, procedura e prokurimit dhe nëse specifikimet teknike, termat e referencës dhe grafiku i shërbimit janë hartuar në përputhje me këtë legjislacion.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Kushti i vendosur në kontratë në nenin 4, pika 4.2 si dhe në pikën 5.3 të “Specifikimeve Teknike” bashkangjitur kontratës, bie ndesh me VKM nr. 1188, datë 20.8.2008 me ndryshime “Për miratimin e rregullave për importin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin produkteve për mbrojtjen e bimëve”, në të cilin përcaktohen qartë rregullat për magazinimin e këtyre produkteve.

Megjithëse një kusht i tillë është vendosur në kontratë, ai nuk është kundërshtuar nga Drejtoria e Bujqësisë Fier dhe për pasojë, nuk është zbatuar neni 4, pika 4.2 e kontratës nr. 3150, datë 14.4.2017 sipas të cilës kërkohet “të përcaktohen ambientet për magazinimin nga ana e “të kontraktuarit” të preparatit jo më vonë se 2 (dy) ditë) para fillimit të trajtimit” si dhe nuk ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i DB-Fier në ambientet e caktuara për magazinim nga

“i kontraktuari”, sipas pikës 5.3 të Specifikimeve Teknike. *(trajtuar më hollësisht në fq 9 të Raportit).*

**Rekomandoj:** Të merren masa në të ardhmen, që kushtet për “magazinimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve” në kontratat e shërbimit të llojit “Luftimi me pesticid i miut të arave”, të hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për mbrojtjen e bimëve” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre, në mënyrë që të përcaktohen qartë dhe saktë detyrimet e palëve në kontratë.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Grupi i punës për monitorimin e kontratës ngritur me Urdhrin nr. 150, datë 14.4.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të ish MBZHRAU në asnjë rast nuk ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Bujqësisë Fier (për rastin konkret) për të bërë monitorimin fizik të kryerjes së shërbimit sipas grafikut të punimeve bashkangjitur kontratës (nuk ka qenë prezente në momentin e dizefektimit nga OE). Kontrata nr. 3150, datë 14.4.2017 në bazë të legjislacionit për prokurimin publik është kontratë e llojit “shërbim”, duke qënë e tillë në zbatim të nenit 77 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar duhet të ishte bërë monitorimi fizik i zbatimit të saj /kryerjes së shërbimit sipas kushteve të kontratës në mënyrë që të sigurohej nëse cilësia e **shërbimeve** është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori si dhe gjatë kryerjes së **kontrolleve në terren** (nuk rezulton të ketë), të mbahet procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit dhe grupit të punës së ish MBZHRAU. *(trajtuar më hollësisht në fq 9-10 të Raportit).*

**Rekomandoj:** Të merren masa që MBZHR në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë në qarqe, monitorimi i kontratave të shërbimit të llojit “Luftimi me pesticid i miut të arave”, të bëhet edhe në terren, në momentin e kryerjes së shërbimit nga operatori ekonomik sipas grafikut të shërbimit pjesë e kontratës, në zbatim të nenit 77 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi monitorimi i saj vetëm përmes dokumentacionit fizik nuk mund të quhet i realizuar.

**Në vijimësi**

**4.Gjetje nga auditimi:** Me Urdhër Shpenzimin nr. 186, datë 8.6.2017 është likuiduar OE “G G” në vlerën 18,456,528 me TVSH si dhe me Urdhër Shpenzimin nr. 187, datë 8.6.2017 është likuiduar OE “A I” në vlerën 73,826,112 lekë me TVSH. Likuidimi është bërë bazuar në faturat tatimore të shitjes nr. 161, datë 30.5.2017 dhe nr. 601, datë 30.5.2017. Konstatohet se faturat tatimore të shitjes nuk janë plotësuar nga shitësi (OE) në të gjithë elementët e saj me sasi dhe çmim/njësi, por është plotësuar vetëm vlera në lekë, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014, datë 27.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime, neni 101 si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 6. Gjithashtu likuidimi nuk është bërë në total për llogari të bashkimit të operatorëve por është bërë për secilin operator ekonomik veçmas. Në kontratën nr. 3150, datë 14.4.2017, neni 9, është përcaktuar në mënyrë jo të qartë se pagesat do të kryhen nga AK në llogaritë bankare të OE-ve, por nuk është përcaktuar vlera e shërbimit të kryer për secilin nga operatorët ekonomikë kundrejt faturave të paraqitura. Nga operatorët ekonomikë nuk është llogaritur sasia e sipërfaqes që i është kryer shërbimi, pasi në faturat tatimore të shitjes të paraqitura prej tyre nuk figuron një veprim i tillë dhe pse e kanë detyrim ligjor. *(trajtuar më hollësisht në fq 10 të Raportit).*

**Rekomandoj:** Të merren masa që në të ardhmen, në kontratat e shërbimit të llojit “Luftimi me pesticid i miut të arave”, të sanksionohet qartë dhe saktë mënyra e pagesës (likuidimit) për “të kontraktuarin” në rastin kur ky është një bashkim operatorësh ekonomikë, nëse pagesa do të bëhet për secilin operator ekonomik sipas përqindjes në bashkëpunim kundrejt faturave të paraqitura prej tyre për shërbimin e kryer.

**Në vijimësi**

## **B. INDICIE PENALE**

Nga auditimi i kryer në ish MBZHRAU mbi bazë të sinjalizimit të bërë në KLSH, me shkresën nr. s'ka, datë 04.7.2017 ku pretendohet se janë shkelur kushtet teknike për zbatimin e kontratës së shërbimit nr. 3150, datë 14.4.2017 me objekt "Luftimi me pesticid i miut të arave" konkretisht në Qarkun Fier për një sipërfaqe prej 2000 ha, si dhe nga konstatimet e dala nga zbatimi i programit "Njoftim për fillim Projekt Auditimi" nr. 732/1, datë 07.9.2017 miratuar nga Kryetari Kontrollit të Lartë të Shtetit, rezulton se:

1. Hartimi i "termave të referencës" pjesë integrale e kësaj kontrate, për përcaktimin e sipërfaqeve që do të trajtohen me pesticid, nuk është detajuar deri në nivel njësie administrative të ndara sipas fshatrave. Kjo ka sjellë përcaktimin fiktiv të sipërfaqeve që do trajtohen me pesticid.

2. Kushti i vendosur në kontratë në nenin 4, pika 4.2 si dhe në pikën 5.3 të "Specifikimeve Teknike" bashkangjitur kontratës, bie ndesh me VKM nr. 1188, datë 20.8.2008 me ndryshime "Për miratimin e rregullave për importin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin produkteve për mbrojtjen e bimëve", në të cilin përcaktohen qartë rregullat për magazinimin e këtyre produkteve.

Megjithëse një kusht i tillë është vendosur në kontratë, ai nuk është kundërshtuar nga Drejtoria e Bujqësisë Fier dhe për pasojë, nuk është zbatuar neni 4, pika 4.2 e kontratës nr. 3150, datë 14.4.2017 sipas të cilës kërkohet "të përcaktohen ambientet për magazinimin nga ana e "të kontraktuarit" të preparatit jo më vonë se 2 (dy) ditë) para fillimit të trajtimit" si dhe nuk ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i DB-Fier në ambientet e caktuara për magazinim nga "i kontraktuari", sipas pikës 5.3 të Specifikimeve Teknike.

3. Monitorimi i kontratës, nuk është bërë fizikisht në vendin e trajtimit nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 150, datë 14.4.2017 e Sekretarit të Përgjithshëm, pasi në asnjë rast ky grup nuk ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Bujqësisë Fier, për të monitoruar në vend kryerjen e shërbimit sipas grafikut të punimeve bashkangjitur kontratës. Ky veprim nuk është bërë në përputhje me nenin 77 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, pasi nuk janë kryer kontrole në terren për realizimin e shërbimit nga i "kontraktuari", veprime të cilat kanë çuar në mos zbatimin e kontratës sipas përcaktimeve ligjore trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të auditimit.

Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar për shkeljet e konstatuara në zbatimin dhe monitorimin e kontratës nr. 3150, datë 14.4.2017 me vlerë 92,287,440 lekë me TVSH, konkretisht për **Qarkun Fier** (objekt i shkresës së sinjalizimit të bërë në KLSH) të ushtruar në ish Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të kryhet trajtimi i detajuar tekniko-juridik nga ana e Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit për indicie penale, për personat e ngarkuar me funksione ligjore në drejtim të zbatimit dhe monitorimin e kontratës.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**